

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11)), sidhe n; bazë të nenit 50 alinea 6 nga Ligji për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së veriore “ nr.161/2019)Ministri për arsim dhe shkencë e solli programin e shkurtuar nga lënda e Shkencave natyrore të klasës së I të arsimit fillor nëntëvjeçarë të vitit shkollor 2020/21.

PROGRAM I SHKURTUAR MËSIMOR



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Shkencat natyrore

KLASA I

SHTATOR 2020

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

1. HYRJA

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore **Shkencat natyrore** bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parapara me programin e rregullt mësimor për këtë lëndë.

Me programin e shkurtuar janë përcaktuara tema dhe njësi mësimore të cilat duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, duke pasur kujdes fondi i orëve javore i paraparë në programin e rregullt mësimor 2 orë në javë gjegjësisht 64 orë gjithsejt.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet, metodat e aktivitetet e përcaktuara në programin e erregullt mësimor.

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda Shkencat natyrore për klasën e i realizohet në vitin shkollor 2020/21

2. Pasqyra e temave dhe njësive mësimore

TEMA 1: NE (10 orë)

Njësitë mësimore:

1. Ngjashmëritë me njëri tjetrin?
2. Me çfarë dallojmë nga njëri tjetri?
3. Kush është më i lartë?
4. Emërtimi i pjesëve të trupit
5. Shqisat
6. Mundeml të prek
7. Mundemi të shohim

8. Mundeml të dëgjomëj
9. Mundemi të shijojmë
10. Mundemi të nuhasim

TEMA 2: PREJ ÇFARË ËSHTË BËË (9 orë)

Njësitë mësimore:

1. Kërkim i materialeve në klasë
2. Kërkim i materialeve jashtë klasës
3. Hulumtim i materialeve
4. Karakteristikat e materialeve
5. Testimi i materialeve
6. Zbulimi dhe emërtimi i materialeve
7. Përzierja e lëngjeve
8. Lojë me balona
9. Klasifikimi i materialeve

TEMA3: TË JETUARIT DHE RRRITJA (10 orë)

Njësitë mësimore:

1. Qenlet e gjalla
2. Dallimet në mes bimëve dhe kafshëve
4. Qenie jo të gjalla
5. Gjallesa dhe kafshë nga mjedisi lokal
6. Bimë nga mjedisi lokal
7. Ushqimi i shëndetshëm.

8. Uji i pastër për pije
9. Prindërit dhe pas ardhësit.
10. Si rritemi

TEMA 4: SHTYRJE DHE TËRHEQJE – FORCA (11 orë)

Njësitë mësimore:

1. Çfarë lloj lëvizjesh mund të bëjnë qeniet e gjalla?
2. Si lëvizin kafshët dhe si mund të bëjmë që të lëvizin gjësendet ?
3. Çka është forca?
4. Shtyrja dhe tërheqja
5. Forca e ajrit
6. Mjete komunikacioni që lëvizin
7. Forcat magnetike
8. Hulumtim rreth tërheqjes magnetike
9. Shpejtë ngadalë dhe ndalesa! (Parashikoni si ato do të mund të lëvizin, të përshpejtohen, të ngadalësohen dhe/ose të ndalen)
10. Testimi i sipërfaqeve të rrugëve
11. Lëvizje në drejtime të ndryshme

TEMA 5 : Prodhimi i tingujve (13orë)

Njësitë mësimore:

1. Burimet e tingujve
2. Identifikon burimet e ndryshme të tingujve
3. Në sheti me tingujt
4. Tingujt muzikor
5. Të krijojmë tingujve muzikor
6. Vëzhgim se çfarë mund të bëhet me tingujt.
7. Tingulli dhe largësia

8. A mundet burimet e ndryshme të tingujve të dëgjohen në largësi të ndryshme?
9. Planifikim i hulumtimit të tingujve
10. Zbatimi i hulumtimit për tingujt
12. Tingujt që dëgjohen
13. Bëjmë telefon nga teli dhe konzerva

TEMA 6: KULTIVIMI I BIMËVE (11orë)

Njësitë mësimore:

1. Bimet si qenie të gjalla
2. Emërtim i pjesëve të bimëve
3. Eksperiment me gjethe
4. Përse shërbejnë kërcelli?
5. Kultivimi i farërave.
6. Kultivimi i bimëve më të larta
7. Kultivimi i lulediellit
8. Kultivimi i fasules, kungullit pemëve, bimëve mjekësore, e të ndryshme
9. Sa ujë u nevojitet bimëve?
10. Pa dritë ska jetë
11. Nga fara deri te bima

3. Rekomandimet didaktike

Pikënisja e realizimit të programit të shkurtuar nga lënda e **Shkencave natyrore** është programi i rregullt mësimor i kësaj lënde. Programi mësimor i lëndës Shkencat natyrore për arsimin fillor nëntëvjeçar është përfaqësuar nga katër fusha përmbajtësore: hulumtimi shkencor, biologji, kimi, fizikë.

Hulumtimi shkencor përfshin: idetë dhe dëshmitë, planifikimi i punës hulumtuese, evidentimi dhe shqyrtimi i të dhënave. Hulumtimi shkencor i përforcon dituritë nga biologjia, kimia fizika që janë të fokusuar në zhvillimin e vetëbesimit dhe interesit për përfitimin njohurive shkencore si dhe ngritjen e vetëdijes për mjedisin jetësor.

Programi mësimor përmban përmbledhje të qëllimeve mësimore nga lëmia e shkencave natyrore. Në të detajisht përshkruhet se çfarë duhet të dijë nxënësi dhe çka mund të bëjë nxënësi në klasën e parë. Qëllimet mësimore mundësojnë strukturë të mirë për nxënie dhe mësim dhe udhëzime se cilat aftësi dhe njohuri të nxënësve mund të kontrollohen.

Në programin e shkurtuar mësimor janë përcaktuar njësitë mësimore e disa janë lënë mënjanë por, ruhet mundësia për ti përvetësuar njohuritë dhe shkathtësitë nga secila temë mësimore. Është bërë më e thjeshtë sepse janë planifikuar dy orë për një njësi mësimore p.sh te tema e parë **NE** ka dy orë me njësinë mësimore me titull, Emërtimi i pjesëve të trupit,, Arsimitari mund të përzgjedh se cilin aktivitet në cilën orë do të realizojë.

Në programin e shkurtuar janë lënë mënjanë njësi mësimore qëllimet e të cilave mbulohen planifikimin e njësive të tjera mësimore p.sh. tema: „ Shtyrja dhe tërheqja,, njësia mësimore „ Si mund të bëjmë që lodra të lëvizin,, është lënë mënjanë sepse ka një tjetër njësi me titull: „ Si lëvizin kafshët dhe si mund të bëjmë që gjësendet të lëvizin,,

Më me rëndësi gjatë realizimit të orës mësimore është të planifikohen aktivitete hulumtuese që ju mundësojnë nxënësve që në mënyrë të pavarur të vijnë gjer tek njohuritë dhe të zhvillojnë shpirtin hulumtues ndaj natyrës që e rrethon .

Arsimitari planifikon që ora mësimore të zgjasë 30 minuta. Gjatë planifikimit të orës mësimore duhet që ta shkurtoj pjesën hyrëse të orës mësimore dhe përmes aktiviteteve të përshtatshme dhe resurseve të nxit dhe motivojë nxënësit për realizimin e orës dhe arritjen e qëllimeve mësimore.

Për realizimin efikas të njësive mësimore të këtij programi e posaçërisht realizimi i aktiviteteve hulumtuese kërkon përgatitje të veçantë të arsimitarit. Zbatimi i qasjes së integruar gjatë planifikimit mundëson fleksibilitet në organizimin e mësimi. Kjo do të thotë se gjatë planifikimit të orës mësimore /orët e Shkencave natyrore maksimalisht shfrytëzohet mundësia e integritit dhe lidhshmërisë me lëndët e tjera mësimore.

Realizimi i qëllimeve mësimore dhe arritja e rezultateve të pritura gjatë orës mësimore që është 30 minuta është lehtësuar puna për shkak të numrit të vogël të vogël të nxënësve që do të jenë fizikisht në klasë (15-20 nx.) me çka fitohet në kohë gjatë kontrollit diagnostifiki të paranjohurive të nxënësve si dhe gjatë vlerësimit të të arriturave të nxënësve gjatë orës mësimore.

Në përputhje me programin mësimor të lëndës Shkencat natyrore të klasës së parë, kontrollimi dhe vlerësimi i nxënësve me shkrim duhet të realizohet me gojë, praktikisht përmes prezentimeve dhe aktiviteteve e ushtrimeve të përshtatshme për nxënësit.

Gjatë realizimit të orëve mësimore të lëndës mësimore Shkencat natyrore me prezencë fizike është e domosdoshme të respektohen protokollit për distancë dhe mbrojtje personale.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programi i shkurtuar mësimor e realizon arsimtari sipas normativit për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar nga lënda Shkencat natyrore të klasës së parë të arsimit fillor nëntëvjeçar e miratoi

MINISTËR I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Mila Carovska